

VENDIM
Nr.562, datë 28.5.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË RI TË STUDIMIT “MASTER I NIVELIT TË DYTË”,
PRANË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE PRIVATE “JUSTINIANI I”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e shkollës së lartë universitare private “Justiniani I”, me seli në Tiranë, për hapjen e programit të studimit “Master i nivelit të dytë” në shkencat juridiko-penale.

2. Programi i studimit “Master i nivelit të dytë” do të jetë program studimi i ciklit të tretë, në plotësimin e të paktën 60 krediteve. Në përfundim të programit të studimit do të lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë”, (MND), në shkenca juridiko-penale.

3. Ngarkohet shkolla e lartë universitare private “Justiniani I” që, për programin e studimit, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, nga një personel akademik, me kualifikimin e nevojshëm dhe sipas specialitetit.

4. Shkolla e lartë universitare private “Justiniani I” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programin e studimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se dy javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni mësimor ka përmbushur angazhimet e deklaruar, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, forma studimi, plane dhe programe, si dhe elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Shkolla e lartë universitare private “Justiniani I” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të këtij programi studimi, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Shkolla e lartë universitare private “Justiniani I”, pas marrjes së lejes përkatëse për programet e ciklit të tretë, nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, strukturohet si universitet.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha